




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QËNDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER**

Nr . 171 Prot

Fier , më 12.03.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJËRËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ” , të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr. 759 datë.30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”, i ndryshuar

Qendra e Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin me kohë të pjesshme :

- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik” në Berat 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik” në Lushnjë 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” në Berat 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike” në Mallakaster 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Parukeri ” në Lushnjë 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Rrobaqepsi ” në Lushnjë 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Servis xhenerik në automjetet e lehta” në Fier 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Servis xhenerik në automjetet e lehta” në Lushnjë 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Aftësi Digjitale “në Lushnjë 1 (një) person.

- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “Servis xhenerik në automjetet e lehta” ‘në Berat 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Aftësi për punësim ‘në Berat 1 (një) person.
- instruktor i praktikës profesionale në Kursin “ Aftësi për punësim ‘në IEVP Lushnje 1 (një) person.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- Të ketë të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë punë në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën/deftesë e shkollës së mesme;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim punë nga punëdhënësi të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së, brenda datës
26.03.....2026 .

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njërezore, përbërjen e njësive së zhvillimit të institucionëve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.

DREJTOR

Klotilda NAÇO

